



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR

Nr. 5847 Prot.

Tiranë, më 03.10.2024

Lënda: Dërgohet udhëzimi për njohje dhe zbatim.

AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ✓

Rr. "Aleksandër Moisiu", përballë IKV, Tiranë

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR

Rr. "Naim Frashëri", Tiranë

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Bulevardi "Zhan d'Ark", Tiranë

Bashkëlidhur, gjeni për njohje dhe zbatim udhëzimin e përbashkët nr. 712, datë 19.09.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 28, datë 16.10.2023 "Për kushtet dhe procedurat për transferimin nga arsimit i përgjithshëm (gjimnaz) në arsimin profesional dhe anasjelltas".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT

MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Nr. 1125/Prot. Datë 27.9 2024

Nr. 5392/1/Prot. Datë 26.9 2024

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 71 Datë 1.10 2024

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 28, DATË 16.10.2023
"PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR TRANSFERIMIN NGA ARSIMI I
PËRGJITHSHËM (GJIMNAZ) NË ARSIMIN PROFESIONAL DHE ANASJELLTAS**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 20, pika 5, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJMË:

1. Në udhëzimin nr. 28 datë 16.10.2023 "Për kushtet dhe procedurat për transferimin nga arsimi i përgjithshëm (gjimnaz) në arsimin profesional dhe anasjelltas", bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

a) Pika 1 e nenit 4 ndryshon si më poshtë vijon:

"1. Transferimi i nxënësit nga gjimnazi, në arsimin e mesëm profesional dhe anasjelltas, lejohet gjatë ndjekjes së klasës së 10-të, si edhe kur nxënësi ka përfunduar klasën e dhjetë. Ky rregull vlen edhe kur nxënësi ka ndjekur arsimin e përgjithshëm parauniversitar jashtë vendit."

b) Pika 3 e nenit 4 ndryshon si më poshtë vijon:

"3. Nxënësit të cilët transferojnë studimet nga jashtë shtetit në Republikën e Shqipërisë, gjatë klasës së 10-të ose pasi kanë mbaruar klasën e 10-të, në arsimin e mesëm të përgjithshëm ose në arsimin e mesëm profesional, duhet të paraqesin programin mësimor të ndjekur në atë shtet, të përkthyer dhe noterizuar me vulë apostile."

c) Në shkronjën "d" të pikës 2, të nenin 5, togëfjalëshi "gjatë 3-mujorit të parë" zëvendësohet me togëfjalëshin "gjatë klasës së 10-të".

Adresa: Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Tiranë. web: www.meki.gov.al E-mail: info@meki.gov.al

d) Pika 3 e nenit 5, ndryshon si më poshtë vijon:

“3. Nxënësve që transferohen nga gjimnazi në arsimin profesional, gjatë ndjekjes së klasës 10 ose në përfundim të klasës së 10-të, shkolla iu krijon mundësi për të plotësuar mangësitë teorike dhe praktike në kulturën profesionale. Periudha e plotësimit të mangësive është dy muaj, për nxënësit që transferohen në përfundim të klasës së 10 dhe jo më shumë se dy muaj, për nxënësit që transferohen gjatë klasës së 10 (në varësi të periudhës kohore të munguar në arsimin profesional). Gjatë periudhës së plotësimit të mangësive, mësuesi kujdestar, në bashkëpunim me mësuesit e teorisë dhe praktikës profesionale përkatëse, përgatisin një “plan për mbështetjen teorike/praktike” të nxënësit të transferuar.”

e) Pas pikës 3, të nenit 6 shtohen pikat 3/1 dhe 3/2 me përmbajtje si më poshtë:

“3/1. Përcaktimet e këtij udhëzimi i fillojnë efektet për vitin shkollor 2024-2025 për transferimet nga gjimnazi në arsimin profesional dhe anasjelltas, vetëm për nxënësit që bëjnë transferime gjatë ndjekjes së klasës së dhjetë.”

“3/2. Për nxënësit që kanë përfunduar klasën e 10 (dhjetë) në gjimnaz dhe kërkojnë të vazhdojnë klasën e 11 (njëmbëdhjetë) në arsimin profesional dhe anasjelltas, i fillon efektet në vitin shkollor 2025-2026.”

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Afërsive, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, ofruesit e arsimit dhe formimit profesional dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR
I EKONOMISË, KULTURËS
DHE INOVACIONIT
Blendi GONXHJA

MINISTËR
I ARSMIT DHE SPORTIT
Ogerta MANASTIRLIU